

## **AKTI I THEMELIMIT I SHOQËRISË “CRI SERVICES” SH.P.K.**

Sot më datë 26 Nëntor 2018 **Z. Michalis Georgiadis**, i biri i George Georgiadis, i datëlindjes 23 Korrik 1977, lindur në Athinë, Greqi dhe banues në Athinë, Greqi shpreh vullnetin për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë “**CRI SERVICES**” **SH.P.K.** si më poshtë vijon:

### **1. Forma ligjore e shoqërisë**

Shoqëria “**CRI SERVICES**” **SH.P.K.**, nga këtu e më poshtë në këtë akt, e referuar si shoqëria, themelohet si një shoqëri tregtare në formën e “Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar”, shkurtimisht SHPK.

### **2. Ortakët themelues**

Shoqëria është themeluar nga Ortaku i Vetëm **Z. Michalis Georgiadis**.

### **3. Objekti i veprimtarisë**

Objekti i aktivitetit të shoqërisë “**CRI SERVICES**” **sh.p.k.** do të jetë:

- Shërbime informatike në përgjithësi për industrinë e telekomunikacionit.
- Shërbime marketingu për industrinë e telekomunikacionit, përfshirë shërbime konsulencë, procesim të dhënash, zhvillim programesh.
- Mirëmbajtje, operim dhe shërbime mbështetëse të sistemeve informatike.
- Import/eksport dhe tregëti të hardware dhe software.
- Çdo lloj veprimtarie të ligjshme që konsiderohet fitimprurëse për shoqërinë.

### **4. Selia e shoqërisë**

4.1 Selia e Shoqërisë “**CRI SERVICES**” **sh.p.k.** do të jetë në Tiranë, në adresën: Rruga e Elbasanit, Kulla “American 2”, Zyra 2016, Njësia Administrative Nr.2.

4.2 Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

### **5. Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë të papërcaktuar nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

## 6. Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare “**CRI SERVICES** sh.p.k. është 100 000 Lekë.

E gjithë pjesa e kapitalit themeltar është nënshkruar në tërësinë e saj nga Ortaku i Vetëm themelues.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet edhe me kontributet në natyrë.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themelor të **Shoqërisë** bëhet me vendim të **Asamblesë së Ortakëve**. Fondi në të holla që vjen nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar depozitohet për llogari të **Shoqërisë** në të gjitha Bankat që ndodhen në territorin e Shqipërisë.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar bëhet me akt notarial.

## 7. Drejtimi dhe Administrimi

Shoqëria drejtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe Administratori.

Administratori i parë i shoqërisë “**CRI SERVICES** sh.p.k. është **Znj. Galsvinda Biba**.

Administratori emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, për një periudhë jo më shumë se 5 vjet.

Përfaqësimi i shoqërisë tregtare “**CRI SERVICES** sh.p.k. në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njeh ligji dhe Statuti, i përket Administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkojnë për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

## 8. Shpërbërja dhe likuidimi

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkaku ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjetër që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

**Ortaku i Vetëm**

**Michalis Georgiadis**

*MICHALIS GEORGIADIS*

